



RESOLVE

NETWORK

Kthimi te bazat e hulumtimit mbi ekstremizmin e

Kris Inman

ABSTRAKT

Ky kapitull rishikon bazat e hulumtimit, që nga formulimi i një pyetjeje hulumtimi deri tek etika e hulumtimit, të cilat mund të anashkalohen lehtësisht në hulumtimet e aplikuara të kryera për të kuptuar luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm (LEDH). Kapitulli paraqet shembuj të praktikave të mira dhe të këqija të hulumtimit, si dhe mënyra praktike për të përmirësuar projektet e hulumtimit duke iu kthyer parimeve themelore për mbledhjen dhe analizën cilësore dhe sasiore të të dhënave. Ndërsa kapitulli mund të shërbejë si një udhëzues praktik për projekte të shëndosha hulumtimi, ai shkon përtej elementeve thelbësore të hulumtimit dhe diskuton arsyet përse këto praktika më të mira hulumtimi janë të rëndësishme për politikëbërësit dhe për të përmirësuar njohuritë tona për luftën kundër terrorizmit të dhunshëm.

HYRJE

Puna në fushën e luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm (LEDH) është emocionuese, shpërblyese, por edhe sfiduese. Duke qenë një fushë relativisht e re, vetëm diku te 10 vjet, ne përballemi me një presion të madh në dhënien e reagimeve efektive të LEDH-së me rritjen e vazhdueshme të ekstremizmit të dhunshëm (EDH) në mbarë botën, pavarësisht përpjekjeve aktive kundër terrorizmit të 20 viteve të fundit. Ne jemi në kërkim të vazhdueshëm për të gjetur prova se çfarë funksionon dhe çfarë nuk funksionon, çfarë është e shkallëzueshme dhe e qëndrueshme dhe cilat janë pasojat e padëshiruara që fshihen pas qëllimeve më të mira. Përballë grupeve në zhvillim të shpejtë të EDH-së, si Shteti Islamik, Boko Haram, Al Qaeda, Al Shabaab dhe veprimtari të tjera terroriste lokale në mbarë botën, mund të duket sikur ne jemi gjithmonë të paktën një hap prapa dhe duke projektuar gjithçka nga e para në përgjigjet tona ndaj EDH-së. Një fushë ku mund ta shmangim këtë të fundit, duke adresuar në këtë mënyrë çështjen e ekstremizmit të dhunshëm, është mënyra se si kryejmë hulumtime mbi LEDH-në. Parimet dhe praktikat më të mira të hulumtimit kanë baza të forta dhe transferohen në të gjithë sektorët dhe të gjitha disiplinat. Ky kapitull rishikon disa nga praktikat më të mira të cilat, kur zbatohen në hulumtime, përmirësojnë kapacitetin e hulumtuesve dhe analistëve për të mbështetur politikat dhe programet e LEDH-së dhe përpjekjet e tjera për vendosjen e paqes.

Studimi dhe reagimi ndaj EDH-së kërkon qasje novatore dhe fleksibël që të mund të trajtojnë kompleksitetin e dinamikës së EDH-së. Sidoqoftë, kur krijohet inovacion në sferën e hulumtimit, hulumtuesit dhe analistët shpesh harrojnë parimet kryesore të projektit të hulumtimit. Këto parime përfshijnë formulimin e një pyetjeje jonormative që u përgjigjet pyetjeve “kush”, “si”, “pse”, “ku” ose “çfarë”; përcaktimin e qartë të koncepteve në pyetjen hulumtuese; krijimin e një qasjeje hulumtuese që i vlerëson saktë ato koncepte; mbledhjen dhe analizimin sistematik të të dhënave për t’iu përgjigjur pyetjes hulumtuese me dëshmi; diskutimin në mënyrë të qartë të deduksionit bazuar në dëshmi; dhe respektimin e standardeve etike.

Fuqia e kthimit te bazat nuk duhet të nënvlerësohet, as nga hulumtuesit me përvojë. Ndërsa inovacioni është i nevojshëm në hulumtimet mbi EDH-në, ai gjithashtu duhet të mbështetet në një bazë të fortë të teknikave themelore të hulumtimit. Mosrespektimi i bazave i pengon ekspertët e fushës që të ndërtojnë korpusin e nevojshëm të njohurive për të zhvilluar një kuptim më të mirë të EDH-së dhe rrjedhimisht pengon avancimin e përgjigjeve ndaj EDH-së. Për më tepër, kjo na pengon të ofrojmë dëshmi të qëndrueshme për politikëbërësit.

FORMULIMI I PYETJES HULUMTUESE

Fuqia e korpusit të njohurive rreth një tematike siç është EDH-ja varet nga fuqia e projekteve hulumtuese individuale që kontribuojnë në ato njohuri. Fuqia e një projekti hulumtues individual fillon me formulimin e një pyetjeje të mirë hulumtuese. Pyetjet e mira hulumtuese janë të artikuluar qartë; janë jonormative, duke pyetur rreth çka **është** në vend të çka **duhet të jetë**; dhe përcaktojnë qartë nëse hulumtimi në fjalë ka për qëllim të përshkruajë, shpjegojë, parashikojë ose përjashtojë/ndalojë temën. Sa raporte dhe artikuj hulumtues mbi LEDH-në që artikulojnë qartë një pyetje hulumtuese mund të kujtoni? Nëse ndaleni dhe reflektoni mbi këtë pyetje, me shumë mundësi do të kuptoni se shumë raporte dhe artikuj hulumtues që mund t’ju vijnë ndërmend nuk e ngrenë një pyetje hulumtuese.

Zgjidhni një artikull mbi EDH-në ose LEDH-në dhe shihni nëse mund të identifikoni ndonjë pikëpyetje në hyrje. Nëse ka një pyetje hulumtuese të artikuluar qartë, a është ajo një pyetje e mirë? A mund të hulumtohet për të? Në fushën tonë, shumë pyetje hulumtuese janë formuluar si pyetje me përgjigje “po/jo”, të tilla si “A e mbështesin gratë ‘Boko Haram’?” ose “A është varfëria faktor nxitës i ekstremizmit të dhunshëm?” Pyetjet me përgjigje “po ose jo” nuk i plotësojnë standardet e pyetjeve të mira hulumtuese, sepse pyetjet hulumtuese duhet ta orientojnë audiencën nëse hulumtimi ka të bëjë me përshkrimin, shpjegimin, parashikimin ose përjashtimin/ndalimin e fenomeneve në fjalë.

Një mënyrë për të riformuluar pyetjen “A e mbështesin gratë ‘Boko Haram’,” është të reflektoni mbi atë që ju si hulumtues (ose si politikëbërës, donator apo zbatues) doni të dini për marrëdhënien midis grave dhe “Boko Haram”. A dëshironi të dini **nëse** disa gra e mbështesin “Boko Haram”? Nëse po, një mënyrë më e mirë për të formuluar pyetjen është “Në çfarë mënyrash e mbështesin ‘Boko Haram’ gratë në Nigerinë Veriore?” dhe ndoshta edhe “Cilat janë karakteristikat demografike të grave që mbështesin ‘Boko Haram’?” Ose, a dëshironi të dini arsyen **pse** disa gra e mbështesin “Boko Haram”? Në këtë rast, një mënyrë më e mirë për të bërë pyetjen është thjesht “pse disa gra në Nigerinë Veriore e mbështesin ‘Boko Haram’?” A dëshironi të **krahasoni** mbështetjen e grave për “Boko Haram” në të gjitha territoret brenda të cilave “Boko Haram” është aktiv? Nëse po, atëherë mund të bëni një pyetje hulumtuese si p.sh. “Si ndryshon mbështetja e grave për ‘Boko Haram’ në pellgun e liqenit të Çadit nga mbështetja në Nigerinë Veriore dhe pse?”

I lidhur me ngritjen e një pyetjeje të mirë hulumtuese është edhe parashtrimi i një numri të përshtatshëm pyetjesh. Hulumtimi i mirë dhe i konsoliduar bën një pyetje (ose më së shumti dy pyetje të lidhura ngushtë) njëherësh dhe pastaj hulumton plotësisht për atë pyetje. Një nga gjërat e para që mësova si student i diplomuar në klasat e metodave ishte parimi KISS: Keep it Simple, Stupid (Sa më thjeshtë, budalla). Kjo vlente për disa tematika të metodave, por e para ishte numri i pyetjeve hulumtuese që bëmë në hulumtimin tonë. Një projekt hulumtues nuk mund t’u përgjigjet siç duhet tre pyetjeve hulumtuese (nëse nuk jeni duke shkruar një libër). Dhe sigurisht që nuk mund t’u përgjigjet siç duhet 15 pyetjeve hulumtuese, gjë që na kërkohet shpesh neve që kryejmë vlerësime të EDH-së.

Nëse ndodheni në pozita ku duhet t’i jepni përgjigje pyetjeve të shumta hulumtuese në të njëjtin raport dhe keni vetëm disa javë për ta shkruar atë, atëherë ajo që ndodh në mënyrë të pashmangshme është

gjetja e disa provave—shpesh anektodike—për t’iu përgjigjur secilës pyetje. Me fjalë të tjera, dëshmitë për secilën pyetje janë të dobëta dhe seksioni i boshllëqeve të njohurive kthehet në një listë të gjatë të nevojave për të zhvilluar dëshmi të mëtejshme për shumicën e pyetjeve hulumtuese në vlerësimin tuaj. Nuk ka kohë për t’iu përgjigjur në mënyrë sistematike dhe të plotë çdo pyetjeje në një raport që ngre më shumë se një ose dy pyetje—për të mos përmendur faktin që nëse **ijeni** përgjigjur me rigozitet çdo pyetjeje, me siguri do të keni shkruar një traktat prej 1000 faqesh, të cilin nuk do ta lexonte askush.

Formulimi i thjeshtë dhe i qartë i pyetjeve hulumtuese dhe përdorimi i jo më shumë se dy pyetjeve është mënyra e duhur që hulumtuesit të krijojnë një **korpus njohurish**. Akademikët e quajnë këtë program hulumtimi: një përmbledhje e pyetjeve hulumtuese që do të udhëheqin studimin e një teme të caktuar. Një projekt hulumtues i përgjigjet një pyetjeje (ose maksimumi dy pyetjeve). Pastaj akademikët kalojnë në pyetjen tjetër të ndërlidhur që logjikisht rrjedh dhe bazohet në hulumtimet e mëparshme. Është akumulimi i njohurive me kalimin e kohës përmes kësaj metode të thjeshtë dhe sistematike të zhvillimit të një programi hulumtimi që përmirëson njohuritë e botës për shumicën e temave aktuale—që nga ndryshimet klimatike deri te hulumtimet në fushën mjekësore.

USAID (U.S. Agency for International Development-Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar) ka një strategji të ngjashme për zgjerimin e një korpusi ekzistues njohurish përmes programeve të të nxënimit.¹ Sidoqoftë, për shkak se programet e të nxënimit priren të jenë specifike për projektin dhe sistemet dhe proceset nuk janë krijuar për të grumbulluar njohuri nga **të gjitha** projektet, synimet e rritjes më të thellë të njohurive pengohen nga mungesa e proceseve sistematike për shkëmbimin e njohurive nga programet e të nxënimit me donatorët dhe ekspertët e tjerë të fushës jashtë USAID-it. Metastudimet janë të vlefshme; megjithatë, ato nuk mund të zëvendësojnë praktikën e mirë e të vjetër të kufizimit të pyetjeve hulumtuese në një ose dy për projekt dhe prodhimin të një programi hulumtues koherent dhe sistematik, për shkak të natyrës së tyre “post-hoc”.

Si përmbledhje, parimi i parë i hulumtimit është krijimi i pyetjeve që fillojnë me “kush”, “çfarë”, “ku”, “pse” ose “si”, të cilat lehtësojnë përkufizimin, shpjegimin, parashikimin ose përjashtimin. Parimi i dytë është parashkrimi i vetëm një ose dy pyetjeve hulumtuese për projekt dhe hartimi i një plani për hulumtime të mëtejshme që krijojnë një korpus njohurish me kalimin e kohës.

PËRKUFIZIMI I TERMAVE

Kuptimi i duhur i fenomeneve komplekse kërkon krijimin e një korpusi njohurish. Le të marrim, për shembull, presionin e lartë të gjakut. Shkaqet e presionit të lartë të gjakut janë të shumta dhe komplekse; efektiviteti i trajtimeve individuale ose të kombinuara për presionin e lartë të gjakut—ndryshimet në sjellje, dietat dhe medikamentet—janë po aq të shumta dhe komplekse. Shkencëtarët dhe mjekët kanë arritur të zhvillojnë një kuptim më të mirë të shkaqeve të presionit të lartë të gjakut dhe të mënyrës se si duhet të veprohet përmes qindra studimeve të kryera përgjatë kohës, të cilat kanë zhvilluar bazën e dëshmive të nevojshme për të kuptuar dhe trajtuar këtë gjendje shëndetësore. Për fatin e mirë të personave që vuajnë nga presioni i lartë i gjakut, ekziston një përkufizim i përbashkët i fenomenit, si

1 Learning Lab, USAID, i aksesuar në 1 shtator 2019. <https://usaidlearninglab.org/>

dhe një mënyrë e pranuar matjeje. Kjo lehtëson studimin e shkaqeve dhe trajtimeve, duke sistematizuar përkufizimin dhe vlerësimin e sëmundjes në të gjithë trupën e gjerë hulumtuese.

Për shkak se EDH dhe LEDH janë fenomene shoqërore komplekse, hulumtuesit e LEDH-së janë përpjekur të gjejnë përkufizime të përbashkëta.² Vetë termi **terrorizëm** ka mbi 250 përkufizime.³ Kjo shumëllojshmëri e përkufizimeve e bën grumbullimin e korpusit të njohurive në lidhje me shkaqet dhe trajtimet e sëmundjes—në këtë rast, EDH-në—shumë më të vështirë për të paktën tre arsye: 1) Hulumtuesit dhe ekspertët e fushës së LEDH-së vijnë nga disiplina të shumta dhe i përkufizojnë termat bazuar në fushat e tyre përkatëse; 2) mënyra se si perëndimorët e përkufizojnë EDH-në mund të mos ketë lidhje me fshatrat ku ka organizata ekstremiste të dhunshme aktive (OEDH); dhe 3) qeveritë dhe shoqëritë civile në të gjithë globin i përkufizojnë ndryshe EDH-në dhe LEDH-në. Ky seksion diskuton në mënyrë të hollësishme çdo çështje dhe pastaj ofron një mënyrë për trajtimin e saj.

Së pari, hulumtuesit priren ta trajtojnë EDH-në dhe LEDH-në bazuar në supozimet, përkufizimet dhe teoritë e ekspertëve të cilët marrin koncepte dhe projekte hulumtuese nga fushat e tyre përkatëse.⁴ Rezultati është një larmi përkufizimesh dhe teorish të nxjerra nga disiplina të ndryshme, në vend të një përkufizimi dhe teorie ndërdisiplinore. Në mënyrë të ngjashme, programet e LEDH-së—të tilla si ato që synojnë rritjen e kohezionit shoqëror, legjitimitetit dhe qëndrueshmërisë—janë njësoj të vështira për t'u përkufizuar në mënyrë uniforme në të gjitha disiplinat dhe projektet.

Së dyti, për shkak se shumica e koncepteve, teorive dhe matjeve janë zhvilluar nga ekspertë (zakonisht nga perspektivat perëndimore), ato mund të kenë ose jo lidhje me realitetet në terren, kështu që mund të mos jenë të vlefshme. Për shembull, ekspertët mund të sugjerojnë që ulja e EDH-së duhet të matet në sulmet e dhunshme ose vdekjet, ku më pak sulme do të sugjeronin një ulje të EDH-së. Sidoqoftë, kur komunitetet lokale në Afganistan u pyetën se çfarë treguesish përdorin për të kuptuar një ulje të EDH-së, ata ofruan përgjigje të tilla si “aftësia e grave dhe vajzave për të lëvizur në mënyrë të sigurt në komunitet”⁵ dhe prania e antenave satelitore për televizorët. Së treti, qeveritë kombëtare në të gjithë globin e përkufizojnë ndryshe EDH-në dhe LEDH-në, në përputhje me kornizat dhe përparësitë e tyre ligjore; edhe agjencitë kombëtare brenda së njëjtës qeveri miratojnë përkufizime të ndryshme të këtyre termave. Aktorët e shoqërisë civile gjithashtu kanë tendencën t'i përkufizojnë ndryshe këto koncepte.

Për fat të mirë, shkencëtarët në fusha sociale janë të vetëdijshëm për mungesën e konsensusit në përkufizimin e koncepteve të hulumtimit për fenomene të ndërlikuara sociale. Shkencëtarët në fusha sociale kanë bërë prej kohësh përpjekje për t'i caktuar përkufizime të përbashkëta koncepteve të tilla si demokracia, lufta, kryengritja, legjitimiteti, besimi etj. Paqartësinë në përkufizime ata e trajtojnë duke i kushtuar vëmendje të kujdesshme vendosjes së përkufizimeve të tyre brenda një linje kërkimi shkencor që e përkufizon në mënyrë të ngjashme konceptin. Shkenca e mirë sociale i përcakton gjithmonë qartë konceptet kryesore të hulumtimit, një praktikë që hulumtimi rreth LEDH-së duhet ta pranojë dhe ta bëjë praktikën më të mirë.

2 Për diskutim të mëtejshëm të problematikave të përkufizimeve, shihni kontributin e J.M Berger-it në këtë vëllim të redaktuar: J.M. Berger, “Researching Violent Extremism: The State of Play” (Hulumtimi i ekstremizmit të dhunshëm: Situata aktuale) RESOLVE, 23 qershor, 2019, <https://resolvenet.org/research/researching-violent-extremism-state-play>

3 Shihni Alex P. Schmid, ed., *The Routledge Handbook of Terrorism Research*. London, UK: Routledge, 2011, Appendix 2.1 “250-plus Definitions of Terrorism.” (Mbi 250 përkufizime për terrorizmin).

4 Belquis Ahmadi and Eliza Urwin, “Measuring Peace and Violent Extremism” (Vlerësimi i paqes dhe ekstremizmit të dhunshëm) *U.S. Institute of Peace (Instituti Amerikan i Paqes)*, 16 mars, 2018, 1.

5 Ahmadi and Urwin, “Measuring Peace and Violent Extremism” (Vlerësimi i Paqes dhe Ekstremizmit të Dhunshëm) 2.

Nga ana tjetër, shkenca jo e mirë sociale nuk i përkufizon qartë termat dhe shpesh vuan nga zhvendosja konceptuale – kur studimi fillon duke iu referuar një koncepti në një mënyrë, por pastaj e ndërron konceptin shumë herë deri në pikën që, në fund të studimit, koncepti është krejtësisht i ndryshëm.

Shkencëtarët e fizikës së aplikuar, të cilët studiojnë tema që ndjekin ligjet natyrore dhe ligjet e fizikës, kanë Institutin Kombëtar të Standardeve dhe Teknologjisë që udhëheq praktikën e tyre në një mënyrë sistematike.⁶ Ndërsa ne nuk ka gjasa të gëzojmë ndonjëherë këtë nivel të sistemimit të përkufizimeve tona për shkak të natyrës së ndërlikuar sociale të fokuseve tona të hulumtimit, Departamenti i Shtetit ofron deri diku një nivel standardizimi të programeve të ndihmës së huaj me bazë në SHBA (përfshirë paqen, sigurinë, demokracinë dhe qeverisjen), ku zakonisht kategorizohen programet e LEDH-së.⁷ Megjithatë, kjo nuk ka të bëjë me mënyrën se si donatorët e tjerë e përkufizojnë ndihmën e tyre të huaj apo se si agjencitë e tjera qeveritare i përkufizojnë këto terma. Në praktikë, ne duhet të përpiqemi t'i afrohem standardizimit, sepse mënyra se si i përkufizojmë termat përcakton gjithashtu edhe mënyrën se si i matim ato dhe, për rrjedhojë, se si gjetjet shtojnë korpusin e njohurive mbi fenomenin në fjalë.

PROJEKTI I HULUMTIMIT

Pasi pyetja/et hulumtuese dhe përkufizimi/et të jenë bërë të qarta, duhet të ndiqet projekti i hulumtimit. Projekti i hulumtimit i referohet planit të hulumtuesit për secilin element që do të përdoret për të shqyrtuar pyetjen hulumtuese, duke përfshirë përkufizimet, vlerësimin, mbledhjen e të dhënave, menaxhimin e të dhënave, analizën dhe raportimin. Është në thelb receta për mënyrën sesi studiuesi planifikon të kryejë studimin nga fillimi në fund. Këta elementë të projektit të hulumtimit janë artikulluar pothuajse në mënyrë universale në hulumtimet sasiore të publikuara. Sidoqoftë, në hulumtimet cilësore, është e vështirë të gjesh të njëjtin nivel detajesh se si hulumtuesi ka kryer mbledhjen, vlerësimin dhe analizimin e të dhënave. Siç ka shkruar dhe Zeev Maoz para më shumë se 15 vitesh për rastet studimore cilësore:

Ekziston pothuajse një mungesë e plotë e dokumentacionit të qasjes në mbledhjen e të dhënave, menaxhimin e të dhënave dhe analizën e të dhënave dhe deduksionin në hulumtimin e rastit studimor. Ndryshe nga strategjitë e tjera hulumtuese në hulumtimet në fushat politike, ku autorët i kushtojnë kohë dhe përpjekje të konsiderueshme dokumentimit të aspekteve teknike të hulumtimit të tyre, shpesh krijohet përshtypja se përdorimi i rastit studimor e çliron autorin nga çdo lloj nevojë për shqyrtime metodologjike. Rastet studimore janë bërë në shumë raste sinonim i hulumtimeve në formë të lirë ku shkruhet gjithçka dhe autori nuk ndihet i detyruar të tregojë se si ai ose ajo synon ta bëjë hulumtimin, pse është zgjedhur një rast specifik ose një grup rastesh specifike, cilat të dhëna janë përdorur dhe cilat nuk janë përdorur, si janë përpunuar dhe analizuar të dhënat dhe si janë bërë deduksionet nga historia e paraqitur. Megjithatë, në fund të historisë, shpesh hasim përgjithësime gjithëpërfshirëse dhe “mësime” të nxjerra nga rasti.⁸

6 National Institute of Standards and Technology, U.S. Department of Commerce (Institut Kombëtar i Standardeve dhe Teknologjisë, Departamenti Amerikan i Tregtisë), aksesuar në 1 shtator, 2019, www.nist.gov

7 Shihni faqen e internetit të “Standardized Program Structure and Definitions” (Struktura dhe Përkufizimet e Standardizuara të Programit) në <https://2009-2017.state.gov/f/c24132.htm>.

8 Zeev Maoz, “Case Study Methodology in International Studies: From storytelling to hypothesis testing.” (Metodologjia e rasteve studimore në studimet ndërkombëtare: Nga tregimi te testimi i hipotezës.) In *Evaluating Methodology in International Studies: Millennial reflections on International Studies (Metodologjia vlerësuese në studimet ndërkombëtare: Reflektime të mijëvjeçarit për studimet ndërkombëtare)*, ed. Frank P. Harvey and Michael Brecher (Ann Arbor: University of Michigan Press, 2002), 455-75.

Mungesa e këtyre detajeve në hulumtim e bën të pamundur vlerësimin e meritave të projektit të hulumtimit dhe për pasojë, edhe të vlefshmërisë së gjetjeve. Kështu, ne kemi mbetur me shumë hulumtime të dyshimta në praktikën tonë, të cilat ndoshta nuk duhet të kontribuojnë në korpusin e njohurive mbi EDH-në. Nënseksionet e mëposhtme për mbledhjen e të dhënave, matjen dhe deduksionin ofrojnë mënyra për të udhëzuar hulumtuesit që të përmirësojnë hulumtimin dhe të shkruajnë në mënyrë më sistematike për hulumtimet dhe gjetjet e tyre.

Mbledhja e të dhënave

Çfarë lloj të dhënash duhet të mblidhni për t'iu përgjigjur pyetjes suaj hulumtuese dhe si do t'i mblidhni ato? Ky është në të vërtetë thelbi i planit të mbledhjes së të dhënave. Më poshtë paraqiten disa çështje që kanë shqetësuar hulumtuesit e fushës, të cilat duhet të mbahen parasysh.

Problemi nr. 1: Mungesa e mjeteve për mbledhjen e të dhënave. Mjetet për mbledhjen e të dhënave, të tilla si anketat, nuk janë më vetëm metodat tradicionale me stilolaps dhe letër të viteve të mëparshme. Përparimet teknologjike e kanë bërë shpërndarjen elektronike të anketave shumë më të lehtë, gjë që mund të rrisë shumë nivelin e përgjigjeve (veçanërisht nëse të dhënat nevojiten brenda një afati të shkurtër kohor). Anketat mund të dërgohen me email, të plotësohen në një faqe interneti, të mblidhen nëpërmjet telefonit dhe të kryhen në pajisjet celulare. Sidoqoftë, nëse hulumtuesit do të përdorin mjetet teknologjike për të kryer anketën, duhet të sigurohen që ato të jenë funksionale. A kanë pajisjet celulare mjaftueshëm bateri? Si do të karikohen? A punon interneti? Në lidhje me popullsinë, a dinë pjesëmarrësit lexim dhe shkrim? A është anketa e shkruar në një gjuhë që pjesëmarrësit e flasin, lexojnë, shkruajnë ose kuptojnë? A është gjuha e folur e popullatës edhe gjuhë e shkruar? Nëse jo, si do ta drejtoni anketën? Nëse mjeti i mbledhjes së të dhënave është një intervistë ose diskutim me grupe fokusi (DFG), a kanë mbledhësit e të dhënave materialet e nevojshme për të marrë këto të dhëna, të tilla si stilolapsa dhe letra dhe diktofonë funksionale për të regjistruar përmbajtjen?

Problemi nr. 2: Sjellja jokorrekte e anketuesve. Anketuesit,⁹ ndonjëherë me dashje, por më shpesh pa dashje, bëjnë disa zgjedhje delikate në fushën që ndikon ndjeshëm në përgjigjet e të anketuarve, duke përfshirë ndryshimin e formulimit të pyetjeve, kërkimin e përgjigjeve specifike ose bërjen e pyetjeve udhëzuese. Në një projekt hulumtues në terren që kam kryer në Senegal, asistenti i hulumtimit (AH) që punësova për të kryer diskutimet me grupet e fokusit debatoi me pjesëmarrësit dhe u kërkoi që të ndryshonin mendimet e tyre. Në këto situata, është thelbësore të mbikëqyren anketuesit ose asistentët e hulumtimit. Meqenëse vëzhgova diskutimin e parë me grupet e fokusit, pata mundësinë të bëja një bisedë të sjellshme me asistentin e hulumtimit për t'i bërë të ditur se si kisha nevojë që t'i zhvillonte diskutimet e mbetura dhe ne humbëm vetëm të dhënat nga grupi i parë. Gjithashtu, mësova se më duhej të trajnoja anketuesit me të cilët nuk kisha punuar më parë, pavarësisht nga përvoja e tyre e mëparshme si anketues.

⁹ Anketuesit janë personat e punësuar që të dalin dhe të mblidhin të dhëna në terren nëse hulumtuesi nuk i mblidh vetë të dhënat.

Problemi nr.3: Pamundësia për të ndjekur të anketuarit. Nëse mjete i mbledhjes së të dhënave është një anketë ose intervistë në panel, domethënë, një anketë ose intervistë që i bën pyetje të anketuarve të njëjtë herë pas here, atëherë hulumtuesit duhet të ndjekin të anketuarit, gjë që paraqet një problem të gjerë. Është thelbësore të disponohet një plan i mirë për mbajtjen e kontakteve me të anketuarit para se të filloni punën në terren, duke përfshirë mbajtjen e informacionit të kontaktit të të anketuarve në një vend të sigurt.¹⁰ Hulumtuesit duhet të marrin parasysh se si do të ruajnë privatësinë dhe anonimitetin e të anketuarve, veçanërisht për të anketuarit që marrin pjesë në tema të ndjeshme hulumtuese të tilla si EDH. Praktika më e mirë në këtë aspekt është mbajtja e një dokumenti ku çdo të anketuari i vendoset një kod numerik, p.sh., “Jane Doe = e anketuara 1.” Ky dokument duhet të mbahet i veçuar nga çdo e dhënë e mbledhur për të anketuarin. Te vetë të dhënat, te përgjigjet do të vendoset vetëm etiketa “i anketuari 1”. Nëse përgjigja raportohet, ajo duhet të citohet si “I anketuari 1”. Për më shumë informacion në lidhje me këtë problematikë, shihni seksionin e mëposhtëm mbi etikën, por nëse keni dyshime, konsultohuni me Bordin Shqyrtues Institucional (Institutional Review Board, IRB) lokal për praktikën më të mirë në ruajtjen e identiteteve të të anketuarve.

Së fundi, për shkak se hulumtimi mbi EDH-në dhe LEDH-në mund të jetë jashtëzakonisht i ndjeshëm, të anketuarit mund t’u japin identitete të rreme hulumtuesve. Kjo mund të paraqesë një vështirësi praktike për ata që duhet t’u japin financuesve të tyre dëshmi për të vërtetuar se kanë kontaktuar me njerëz të vërtetë për studimin. Mënyra më e mirë që kam gjetur për të trajtuar këtë problematikë është sigurimi që të anketuarit të kuptojnë procesin tim për ruajtjen e të dhënave të tyre, (u komunikohet përmes pëlqimit të informuar – për më shumë informacion shihni seksionin e mëposhtëm mbi etikën) dhe t’u siguroj atyre një dokument të shkruar, të quajtur “Karta e të drejtave të të anketuarve.” Kjo “Kartë e të drejtave të të anketuarve” përshkruan qartë se cilat janë të drejtat e tyre si pjesëmarrës në studim dhe siguron të dhëna kontakti për eprorët dhe institucionin delegues në mënyrë që ata të mund të raportojnë çdo shkelje të të drejtave të tyre që kanë ndodhur në studim.

Problemi nr.4: Mosmarrja parasysh e njëanshmërive të mundshme në mbledhjen e të dhënave. Mënyra se si mbledhen të dhënat mund të krijojë mundësi për njëanshmëri. Kush i bën pyetjet, kujt i bëjmë pyetje, si bëhen pyetjet, mundësitë e përgjigjes dhe renditja e pyetjeve janë mënyra të zakonshme, ku mbledhja e të dhënave mund të shtrembërojë gjetjet ose të rrezikojë përpjekjet për mbledhjen e të dhënave.

Së pari, është e rëndësishme se kush i bën pyetjet. Unë jam një perëndimor që punoj në Afrikën Perëndimore. Kur u bëj pyetje anëtarëve të komunitetit lokal, ata mund të jenë më pak të gatshëm të flasim me mua sesa po të ishte dikush nga vendi i tyre që do t’u bënte të njëjtën pyetje. Prandaj, nëse dua të mbledh të dhëna nga anëtarët e komunitetit lokal, do të zgjedh të punësoj anketues lokalë për të mbledhur të dhënat në vend që ta bëj vetë. Sidoqoftë, nëse dua të mbledh të dhëna nga zyrtarët e Afrikës Perëndimore, mund të zgjedh ta bëj vetë, sepse zyrtarët mund të jenë më të gatshëm për të folur me mua sesa me një nga zgjedhësit e tyre (ose mund të shpresojnë të përmirësojnë marrëdhëniet me qeverinë amerikane përmes pjesëmarrjes në studim etj). Hulumtuesit duhet të mendojnë se çfarë njëanshmëri mund të krijohen bazuar në faktin se **kush** po i mbledh të dhënat dhe më pas të mund të reduktojnë njëanshmëritë ose t’i përmendin si vërejtje në lidhje me gjetjet. Hulumtuesit duhet t’i dokumentojnë gjithmonë njëanshmëritë.

10 Përshtatur nga Dean Karlan and Jacob Appel, *Failing in the Field: What we can learn when field research goes wrong (Dështimi në terren: Çfarë mund të mësojmë kur hulumtimi në terren dështon.)*, (Princeton, NJ: Princeton University Press, 2016)

Së dyti, kujt do t'ia bëni pyetjet? Si do t'i rekrutoni pjesëmarrësit dhe si do ta verifikoni identitetin e tyre për të validuar përfshirjen e tyre? Kur dhe ku do të takoheni me pjesëmarrësit në studimin tuaj për të mbledhur të dhënat e tyre? E thënë ndryshe, cili është procesi që do të ndiqet për përfshirjen në studim? Më poshtë paraqiten disa pika që duhet të merren parasysh kur krijoni planin e përfshirjes në studim:

- Nëse synoni të bëni një anketim, a do të përdorni një kampion përfaqësues apo një kampion të zgjedhur nga kampionimi zinxhir (snowball sampling)? Do të anketoni popullatën e përgjithshme apo zyrtarët?
- Nëse synoni të bëni intervista, do të intervistoni zyrtarë, ish-luftëtarë, shërbime sigurie, shoqëri civile, studentë etj?
- Ku do t'i mblidhni të dhënat? A do të qëndroni në kryeqytet dhe do të pyesni elitat për opinionet e tyre se pse disa komunitete në vendin e tyre janë të cenueshme ndaj EDH-së, apo do të përfshini në mbledhjen e të dhënave edhe banorët e atyre komuniteteve?
- A do të grumbulloni të dhëna vetëm nga komunitetet e cenueshme apo do të përfshini edhe komunitete më të qëndrueshme?
- Cilat janë problematikat që hasen në analizën e secilit prej këtyre vendimeve?

Në krijimin e planit për përfshirjen në studim, hulumtuesit duhet të mendojnë se çfarë lloj të dhënash mund të marrin nga llojet e ndryshme të të anketuarve dhe pastaj të sigurohen që ata të kenë përfaqësimin e duhur mes të anketuarve, pasi të ketë përfunduar grumbullimi i të dhënave. Hulumtuesit duhet të mendojnë gjithashtu se si do të ndikojnë vendimet për përfshirjen në studim në analizën dhe gjetjet e të dhënave.

Së fundmi, **mënyra** se si e bën pyetjen hulumtuesi mund të ndikojë në mbledhjen e të dhënave. Për të kuptuar se pse kjo shikohet si problem, le të marrim një shembull konkret. Le të themi se doni të dini për ankesat e një komuniteti. Një mënyrë për ta bërë këtë është krijimi i një ankete të mbyllur që parashtrohet pyetjen: “Sipas mendimit tuaj, cilat janë sfidat më të mëdha me të cilat përballen ky komunitet” dhe më pas ofrimi i një liste alternativash, p.sh., “qasja në arsim”, “siguria”, “qasja në energji elektrike”, “qasja në kujdesin shëndetësor” etj. Dhënia e alternativave nga të cilat mund të zgjedhin pjesëmarrësit ka si avantazh lehtësimin e analizës së të dhënave, sepse përgjigjet janë dhënë tashmë dhe janë të lehta për t'u koduar.

Sidoqoftë, dhënia e alternativave do të thotë që ju si hulumtues i keni marrë *a priori* vendimet në lidhje me ankesat ekzistuese në komunitet. Po sikur të humbisni ankesat aktuale sepse i keni detyruar të anketuarit të zgjedhin nga lista juaj e ankesave të mundshme? Mënyra për të kapërcyer këtë problematikë të mundshme është të bëni pyetje të hapura. Në këtë rast, bëhet e njëjta pyetje, por nuk ofrohet një listë alternativash. Kjo i lejon të anketuarit t'i artikulojnë ankesat me fjalët e tyre. Ne mund të zbulojmë se, në të vërtetë, ankesa është se zyrtarët lokalë nuk flasin gjuhët lokale, kështu që komuniteti nuk mund të komunikojë me qeverinë e tyre lokale (kjo është një ankesë e zakonshme që kemi dëgjuar në rajonin Liptako-Gourma të Sahelit). Disavantazhi i kësaj qasjeje është se e bën analizën e të dhënave më të vështirë, sepse përgjigjet e pyetjeve të hapura—të cilat janë me natyrë cilësore—duhet të kodohen dhe ky është një proces që kërkon shumë kohë dhe shumë punë.

Rendi i pyetjeve gjithashtu mund të ndikojë në mbledhjen e të dhënave. Në një anketë, nëse së pari pyesni për ankesat dhe më pas pyesni menjëherë për kënaqësinë ose besimin ndaj qeverisë, ka të ngjarë që ta nxisni të anketuarin të japë më shumë përgjigje negative sesa mund të kenë në të vërtetë, sepse ju sapo i keni pyetur për problemet e tyre dhe më pas i kërkuat të vlerësojnë qeverinë e tyre. Ka vëllime të tëra të shkruara për nuancat dhe problematikat në lidhje me rendin e pyetjeve në hulumtimet e shkencave shoqërore; mjafton të themi se duhet të shikohet me kujdes çdo detaj i renditjes dhe formulimit të pyetjeve dhe të peshohen, dokumentohen dhe zbulohen qëllimisht të gjitha vendimet.

Konkluzioni kryesor për parimet themelore të mbledhjes së të dhënave është të kesh një plan të mirëpërcaktuar me rastet kur në mënyrë të pashmangshme dalin gjëra që shkojnë keq në këtë fushë. Nëse mbledhja e të dhënave ka probleme në terren, kjo nuk do të thotë detyrimisht që hulumtimi duhet të fshihet plotësisht. Kjo do të thotë që në raport hulumtuesit duhet të detajojnë çdo çështje që ka lindur me mbledhjen e të dhënave, të dokumentojnë çdo njëanshmëri të mundshme që ka shkaktuar te vetë të dhënat (shih më shumë mbi njëanshmëritë më poshtë) dhe të paralajmërojnë gjetjet në përputhje me rrethanat.

Etika e hulumtimit

Deklarata e Helsinkit (1964)¹¹ krijoi standarde etike ndërkombëtare për hulumtimet mjekësore dhe shërben si udhëzues themelor për kryerjen e hulumtimeve që përfshijnë njerëzit. Fillimisht, deklarata lidhej me hulumtimin mjekësor. Eksperimentet e shkencave sociale siç janë Milgram Experiments (Eksperimentet e Milgramit) (1963)¹² dhe Stanford University Prison Experiment (eksperimenti i burgut nga Universiteti i Stanfordit) (1973)¹³ ngritën problematikën e ndodhjes së shkeljeve të konsiderueshme etike në shkencat shoqërore dhe në Shtetet e Bashkuara. Eksperimente të tilla çuan në shkrimin e Belmont Report (raportit të Belmontit) (1974),¹⁴ i cili përcakton udhëzimet etike kombëtare për çdo hulumtim që përfshin subjekte njerëzore, të cilat shtrihen edhe në hulumtimin mbi kafshët. Sot, çdo hulumtim i kryer duke përdorur paratë federale amerikane dhe që i nënshtrohet pjesës 46 të CFR 45 (Kodi i Rregullores Federale)—e njohur si “Common Rule”—kërkohet ligjërisht të rishikohet nga një Bord Shqyrtues Institucional (IRB) për pajtueshmëri etike. Shumica e vendeve të botës që janë nënshkruese të Deklaratës së Helsinkit kanë IRB-të e tyre (Bordet Shqyrtuese Institucionale); hulumtuesit duhet të kontrollojnë udhëzimet etike dhe ligjet e pajtueshmërisë brenda vendeve të tyre dhe vendeve të studimit.

Shumica e hulumtimeve që përfshijnë njerëz kanë detyrimin ligjor që të jenë në përputhje me rregulloret ndërkombëtare dhe kombëtare të etikës së hulumtimit. Më me rëndësi është fakti se ekspertët e fushës në lidhje me LEDH-në duhet të jenë veçanërisht të ndjeshëm ndaj respektimit të të drejtave të pjesëmarrësve në studim dhe duhet të peshojnë rreziqet dhe përfitimet e përfshirjes së njerëzve për hulumtim. Hulumtimi i LEDH-së është i ndjeshëm dhe mund të rrezikojë jetë. Për më tepër, shumë nga

11 “The Nuremberg Code,” Ethical Principles for Medical Research (‘Kodi i Nurembergut’, Parimet etike për hulumtimet në fushën e mjekësisë), aksesuar më 1 shtator 2019, <https://sites.jamanetwork.com/research-ethics/index.html>

12 Saul McLeod, “The Milgram Shock Experiment” (Eksperimenti i goditjes elektrike i Milgramit), *Simply Psychology*, 2017, <https://www.simplypsychology.org/milgram.html>

13 Saul McLeod, “The Stanford Prison Experiment” (Eksperimenti në burg i Stenfordit) *Simply Psychology*, 2018, <https://www.simplypsychology.org/zimbardo.html>

14 “Belmont Report,” (Raporti i Belmontit) U.S. Department of Health and Human Services (Departamenti Amerikan i Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore), aksesuar në 1 shtator 2019, <https://www.hhs.gov/ohrp/regulations-and-policy/belmont-report/index.html>

pjesëmarrësit në hulumtimin tonë kanë kaluar tashmë trauma të papërshkrueshme dhe ne nuk duhet t'u shkaktojmë atyre më shumë të tilla për hir të hulumtimit. Prandaj, hulumtuesit e LEDH-së duhet të marrin parasysh me kujdes rreziqet e mundshme ndaj të cilave i ekspozojmë pjesëmarrësit në hulumtim. Lexuesit mund të mësojnë rreth udhëzimeve etike përmes IRB-së së tyre lokale ose përmes kërkimit të burimeve online të Departamentit Amerikan të Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore.¹⁵ Në vijim do të përshkruaj disa nga çështjet më të zakonshme etike që lindin në hulumtimin e LEDH-së.

Së pari, hulumtuesit duhet të marrin parasysh çështjet etike që lidhen me rekrutimin e personave në studim. A e detyron studimi në ndonjë mënyrë pjesëmarrjen? Për shembull, nëse po intervistoni ish-luftëtarë në burg, a janë ata të detyruar nga administrata e burgut që të marrin pjesë? Nëse është kështu, kjo është një shkelje e mundshme e të drejtave të tyre. Cili është kompensimi për pjesëmarrjen në studim? A është kompensimi aq i lartë saqë bëhet burim detyrimi për të marrë pjesë në studim? Së dyti, cilat janë rreziqet dhe përfitimet për përfshirjen e pjesëmarrësve në studim? A i tejkalojnë përfitimet rreziqet e mundshme për pjesëmarrësit tuaj? Së treti, në varësi të vendndodhjes ku do të kryhet studimi, a do të dëgjohen pjesëmarrësit nga të tjerët dhe a paraqet kjo problematika etike (ose vlefshmërie)? Nëse jeni duke punuar në komunitete që kanë një prani aktive të OEDH-ve, si do të siguroheni që OEDH-të të mos zbulojnë se cilët janë pjesëmarrësit tuaj në studim? Hulumtimet në terren të kryera brenda komuniteteve nën kërcënimin aktiv të EDH-së janë vulnerabël dhe për të ruajtur sigurinë si të pjesëmarrësve në hulumtim ashtu edhe të anketuesve, këto pyetje duhet të merren parasysh seriozisht. Së katërti, siç u diskutua më lart, si do ta ruajë hulumtuesi identitetin e pjesëmarrësve?

Marrja e pëlqimit nga secili pjesëmarrës në studim është mënyra më e mirë për të siguruar që studimi juaj të mbetet brenda rregullave etike. Pëlqimi i informuar është një dokument që nënshkruhet nga ju dhe pjesëmarrësi në studim. Ky dokument tregon qartë të dhënat tuaja, institucionin tuaj, kualifikimet tuaja, financuesin e studimit, mënyrën se si do të përpunohen, ruhen, analizohen dhe raportohen të dhënat, rreziqet dhe përfitimet për pjesëmarrësin, të drejtat e pjesëmarrësve (p.sh. ata kanë të drejtë të mos marrin pjesë në studim ose të largohen nga studimi në çdo kohë, pa asnjë penalitet etj.), si dhe paraqet të dhënat e kontaktit të eprorëve dhe institucionit tuaj në mënyrë që pjesëmarrësi të mund të raportojë çdo shkelje të etikës ose pasojë negative të pjesëmarrjes në studim. Ju gjithashtu duhet të merrni gjithmonë leje për të përdorur fotografi të personave. Nëse bëni fotografi të fëmijëve, fillimisht duhet t'u merrni leje atyre dhe prindërve ose kujdestarëve të tyre.

Ashtu si me bazat e tjera të hulumtimit të përmendura në këtë kapitull, na takon neve t'i shqyrtojmë me kujdes këto konsiderata etike dhe të kemi një plan të mirëpërcaktuar për t'i adresuar ato. Mosrespektimi i standardeve etike mund të ketë pasojë jo vetëm për studimin që shkel etikën, por edhe për studimet dhe programet e ardhshme dhe jetën individuale. Të jeni të sigurt se çdo shkelje e etikës do të rrezikojë grupin e hulumtimit dhe hulumtuesit e ardhshëm nuk do të kenë të njëjtin akses në të dhëna. Ajo gjithashtu do të dëmtojë çdo program që ndërmerret në komunitet bazuar në gjetjet e hulumtimit. Në rastet më të këqija, mund të ndikojë negativisht te pjesëmarrësit në studim ose në komunitetin më të gjerë.

15 "IRB Registration," (Regjistrimi i IRB), U.S. Department of Health and Human Services (Departamenti Amerikan i Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore), aksesuar në 1 shtator 2019, <https://www.hhs.gov/ohrp/register-irbs-and-obtain-fw/irb-registration/index.html>

Matja

Disa lexues mund të mendojnë: “po unë bëj hulumtime cilësore. Nuk merrem me matje.” Unë, me gjithë respektin, lutem të ndryshoj. Siç shkruanin King, Keohane dhe Verba mbi 25 vjet më parë, qasjet cilësore dhe sasiore janë thjesht “dy modele hulumtimi me një logjikë deduktive.”¹⁶ Duke lënë mënjanë përparimet në fushën e hulumtimit cilësor, ku konceptet tani maten përmes kodimit ose analizës teorike të bashkësive/grupeve,¹⁷ për hulumtimin cilësor zbatohen parimet bazë të matjes. Kjo ndodh sepse parimet bazë të matjes mbështeten në një bazë logjike. Logjika vlen për të gjitha hulumtimet, sasiore dhe cilësore.

Në rastin më ideal, ekspertët në fushën e LEDH-së do të kishin një grup të unifikuar njësisht matëse për t'i zbatuar në lloje të ngjashme programesh për të krijuar një korpus njohurish që përdor përkufizimet dhe mat konceptet kryesore në të njëjtën mënyrë. Sidoqoftë, kjo fushë nuk është akoma në këtë fazë.¹⁸ Në mungesë të përkufizimeve të dakordësuara për konceptet kryesore të EDH-së dhe LEDH-së, është veçanërisht e rëndësishme që të tregohet kujdes për mënyrën se si i masim përkufizimet që përdorim. Parimet kryesore të matjes janë vlefshmëria dhe besueshmëria, të cilat, kur respektohen, ndihmojnë në standardizimin e praktikës hulumtuese. Mosmarrja në konsideratë e çështjeve të matjes shpesh bën që hulumtuesit të mbeten prapa në matjen e produkteve, të tilla si numri i përfituesve, apo rezultatet përfaqësuese, si për shembull kohezioni i komunitetit, mbështetja në rastin e përdorimit të dhunës ose perceptimi anti-amerikan. Rezultatet përfaqësuese të tilla zakonisht u lënë ekspertëve të fushës të LEDH-së pak informacion mbi përvojën aktuale të një komuniteti përfitues me EDH.¹⁹ Për më tepër, pa një grup të unifikuar njësisht matëse, është praktikisht e pamundur të sigurohen dëshmi për të mbështetur teoritë e aspekteve që funksionojnë dhe atyre që nuk funksionojnë në kontekste të ndryshme.

Vlefshmëria dhe Saktësia

Vlefshmëria, ose saktësia, përshkruan afërsinë e një matjeje me vlerën e vërtetë. Kjo është ideja themelore që qëndron pas vlefshmërisë së konstruktit, të cilën do ta diskutojmë më poshtë. Dy lloje të tjera të rëndësishme të vlefshmërisë për praktikën tona hulumtuese janë vlefshmëria e brendshme dhe e jashtme. Në këtë seksion diskutohen të treja llojet e vlefshmërisë, si dhe problemet me të cilat përballemi në matjen e EDH-së dhe LEDH-së.

Vlefshmëria e konstruktit

Vlefshmëria e konstruktit do të thotë që mjeti i hulumtimit mat konceptin që dëshironi të matni. Ajo qëndron në zemër të një prej sfidave më të mëdha në fushën LEDH-së: vlerësimi se çfarë është EDH dhe çfarë do të thotë të luftosh EDH-në. Pyetjet tona hulumtuese dhe vlerësuese kanë të bëjnë pothuajse gjithmonë me një sjellje, d.m.th. kryerjen e akteve terroriste, ngjarjet e dhunshme ose procesin e radikalizimit. Megjithatë, shumica e atyre që fusha jonë i konsideron si hulumtime të përparuar nuk

16 Gary King, Robert O. Keohane, and Sidney Verba, *Designing Social Inquiry: Scientific inference in qualitative research* (Hartimi i Hetimit Social: Konkluzion shkencor në hulumtimin cilësor), (Princeton, NJ: Princeton University Press, 1994), 3.

17 Shihni, për shembull, King, Keohane, and Verba, *Designing Social Inquiry (Hartimi i hetimit shoqëror)*; and Ragin, Charles C. 2000. *Fuzzy-Set Social Science*. Chicago, IL: Chicago University Press.

18 Peter Romaniuk, “Does CVE Work? Lessons Learned from the Global Effort to Counter Violent Extremism” A funksionon LEDH? Mësimet e nxjerra nga përvoja globale në luftën kundër terrorizmit”, *Global Center on Cooperative Security* (Qendra Globale për Sigurinë Bashkëpunuese), shtator 2015, 35–36.

19 Ahmadi and Urwin, “Measuring Peace and Violent Extremism”(Matja e paqes dhe ekstremizmit të dhunshëm) 1–2.

e matin sjelljen. Në vend të kësaj, ne mbështetemi në matjet e qëndrimit—shpesh çka të anketuarit mendojnë se do të besojnë në të ardhmen—në anketa dhe eksperimente të listuara, të tilla si nëse të anketuarit mbështesin një OEDH ose mendojnë se dhuna ndonjëherë është e justifikueshme; ndonjëherë ne thjesht mbështetemi në ndjenjat antiamerikane. Ndërsa kjo mund të shërbejë si një masë përfaqësuese (duhet të bëjmë më shumë hulumtime për ta vlerësuar këtë) në mungesë të matjes së sjelljes aktuale, na duhet që gjithmonë të paralajmërojmë se ka hulumtime të tilla dhe të jemi të drejtpërdrejtë në lidhje me shtrirjen e kontributit të tij domethënës në shpjegimin e sjelljes së EDH-së.

Megjithatë, matja e qëndrimeve është plotësisht e përshtatshme për pyetjet mbi qëndrimin në fushën tonë. Për shembull, ne mund të dëshirojmë të dimë: Cilat janë besimet e njerëzve të X? Cilat janë perspektivat e qytetarëve për qeverinë dhe ndërmjetësit e tjerë me influencë—përfshirë OEDH-të—në vendin e tyre? Cilat janë ankesat e qytetarëve? Megjithatë, matja e qëndrimeve për këto tema është e vështirë. Së pari, njerëzit mund t'i interpretojnë ndryshe pyetjet mbi qëndrimin. Edhe me anketat, të cilat përbëjnë ndoshta mjetin më të standardizuar dhe më të sistematizuar për mbledhjen e të dhënave në hulumtimin mbi LEDH-në, është e vështirë të sigurohet që të anketuarit të interpretojnë në të njëjtën mënyrë qoftë edhe pyetjet më të thjeshta. Kjo është edhe më problematike kur marrim në konsideratë edhe përkthimet e përgjigjeve të anketës. Përfshirja e studimit, personi që bën pyetjet dhe mënyra se si bëhen pyetjet (shih diskutimin e mësipërm) gjithashtu mund të ndikojnë në përgjigjet ndaj pyetjeve mbi qëndrimin dhe për rrjedhojë edhe te matja.

Së dyti, qëndrimet ndryshojnë. Siç theksojnë Zaller dhe Feldman, hulumtimi i anketës supozon se të anketuarit kanë mendime të zhvilluara mjaft mirë për pyetjet e parashtruara dhe se “pikëpamja standarde e hulumtimit të opinionit publik) është se kur të anketuarit thonë se ata favorizojnë X ata thjesht po përshkruajnë një gjendje ekzistuese që favorizon X.”²⁰ Sidoqoftë, ndryshimet në përgjigjet ndaj së njëjtës pyetje kur bëhet në mënyrë të përsëritur, ndryshimi i përgjigjeve kur bëhen ndryshime të parëndësishme në pyetje ose përgjigje apo reagimet ndaj kontekstit në të cilin parashtrohen pyetjet dhe ndryshimet e përgjigjeve kur ndryshohet renditja e pyetjeve e vënë në dyshim këtë supozim kritik. Këto sjellje sugjerojnë se të anketuarit përgjigjen pa u menduar. Nëse një të anketuari i bëhet e njëjta pyetje pas disa ditësh, javësh ose muajsh—ndërkohë që ai/ajo mund të ndikohet nga ngjarjet në mjedisin përreth—mund të nxisë përgjigje të paqëndrueshme, duke e bërë matjen jo të besueshme dhe të pavlefshme.

Së treti, anketat mund të mos jenë të pavlefshme së brendshmi (shih përkufizimin më poshtë) në rast se pyetjet janë idealiste—të bazuara kryesisht në idealet demokratike perëndimore—që nuk kapin qëndrime të vlefshme. Një sfidë tjetër për vlefshmërinë e brendshme të anketave (si dhe intervistat dhe diskutimet me grupet e fokusit) është psikologjia njerëzore. Për shembull, njerëzit prirën të japin përgjigjet që ata mendojnë se do t'u pëlqejnë të tjerëve (njëanshmëria në baza të pëlqimit social).

Këto çështje shtrojnë nevojën që hartuesit e anketave dhe anketuesit të kenë trajnim formal në fushën e psikologjisë së anketimit për të ditur si të sillen. Përvoja me anketimin nuk e zëvendëson këtë trajnim të rëndësishëm; përkundrazi, ka më shumë gjasa të garantojë që hulumtuesit të zgjedhin rrugë të shkurtra dhe të përdorin instrumente të dobëta.

20 Stanley Feldman and John Zaller, “The Political Culture of Ambivalence: Ideological Responses to the Welfare State,” (Kultura politike e ambivalencës: Përgjigje ideologjike për Shtetin e Mirëqenies), *American Journal of Political Science (Revista Amerikane e Shkencave Politike)*, 36(1) 1992: 268-307.

Vlefshmëria e brendshme

Vlefshmëria e brendshme i referohet faktit nëse rezultatet e hulumtimit janë të vlefshme (të vërteta) për subjektet e studimit. Ndërsa ne mendojmë zakonisht për vlefshmërinë e brendshme në eksperimente ose hulumtime sasiore, është po aq e rëndësishme që ajo të merret parasysh edhe në hulumtimin cilësor. Në hulumtimet cilësore, ne shpesh mbështetemi tek intervistat dhe diskutimet mes grupeve të fokusit, zyrtarëve dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC). Për shembull, kur bëjmë vlerësime të EDH-së për të siguruar informacion për hartimin e programit, ne priremi të kontaktojmë informatorët që janë të njohur për donatorët ose qeveritë tona. Pasi kam kryer dhjetëra—për të mos thënë qindra—intervista dhe diskutime të tilla me grupet e fokusit, unë kam akoma dyshime lidhur me vlefshmërinë e tyre së brendshmi. Subjektet e studimit synohen të jenë popullata të cenueshme nga EDH ose OEDH, por, kjo teknikë në fakt nuk mbledh informacione nga popullatat e cenueshme. Përkundrazi, metoda mbledh informacion nga elitat në lidhje me opinionet e tyre për popullatat e cenueshme.

Ne dëgjojmë pa pushim se si të rinjtë dhe të varfrit janë të cenueshëm, me shumë pak dëshmi ose njohuri të drejtpërdrejta për të mbështetur këtë pohim. Rrjedhimisht, donatorët krijojnë programe për të rinjtë dhe të varfrit bazuar në opinionet e elitave ose të popullatave të aksesueshme mbi cenueshmërinë e tyre, kur, në realitet, të rinjtë dhe popullatat më të varfra mundet të jenë ose jo të cenueshme. Për më tepër, individët mund të mos jenë as njësia e duhur e analizës; për rrjedhojë mund të na duhet të marrim në konsideratë komunitetet e cenueshme. Mbështetja e tepërt tek elitat për mbledhjen e të dhënave mund ta bëjë hulumtimin të pavlefshëm së brendshmi—domethënë, rezultatet nga hulumtimi nuk vlejnë për subjektet e studimit (popullatat e cenueshme) për të cilat duam të informohemi. E thënë ndryshe, ne thjesht kemi subjektet e gabuara të studimit në hulumtimin tonë.

Për shembull, dikur kam qenë përfshirë në një program për zhvillimin pozitiv të të rinjve, ku punoja me të rinj të varfër dhe të paarsimuar në Tunizi. Këta të rinj ishin identifikuar si popullatë e cenueshme nga EDH përmes vlerësimit të kryer përpara hartimit të programit. Ky vlerësim u mbështet në shqyrtimin e të dhënave të studimeve ekzistuese (të cilat përbëheshin pothuajse tërësisht nga intervista të elitave dhe diskutime të grupeve të fokusit me OSHC-të) dhe disa intervista të tjera të elitave, kryesisht me zbatues të tjerë. Pasi filluam programin, “Tunisian Center for Research and Studies on Terrorism, (CTRET)” (Qendra Tuniziane për Hulumtime dhe Studime mbi Terrorizmin) publikoi një studim që rishikonte dokumentet e gjykatës nga një kampion prej një mijë terroristësh të supozuar në sistemin gjyqësor të Tunizisë për të përcaktuar karakteristikat demografike të këtyre terroristëve të supozuar.

Në kundërshtim me atë që na thanë të intervistuarit në vlerësimin tonë—se popullata e cenueshme në Tunizi ishin të rinjtë të varfër dhe të paarsimuar—ky studim tregoi se 40 për qind e terroristëve të supozuar kishin diplomë universitare dhe 33 për qind kishin diplomë të shkollës së mesme.²¹ Edhe pse grupmosha e të rinjve është shpesh aq e gjerë sa të përfshijë çdo person të moshës 15-35 vjeç ose 15-40 vjeç, studimi zbuloi ndryshime në grupmoshat më të vogla: 204 persona ishin midis moshës 18 dhe 24 vjeç, 275 ishin midis moshës 25 dhe 29 vjeç dhe 243 ishin midis moshës 30 dhe 34 vjeç. Shumica nga një mijë personat në studim ishin burra (965), megjithëse kishte gjithashtu 35 gra. Më shumë se gjysma (536) ishin beqarë, 24 për qind (239) ishin të martuar dhe 1 për qind ishin të divorcuar ose të ve. Për

21 “A large proportion of terrorists in Tunisia are university graduates (study),” (Një pjesë e madhe e terroristëve në Tunizi janë të diplomuar në universitet (studim), Agence Tunis Afrique Presse, 26 tetor, 2016, <https://www.tap.info.tn/en/Portal-Society/8362201-a-large-proportion-of-terrorists-in>)

projektin e Tunizisë kjo do të thoshte se fokusi te komunitetet më të varfra dhe më pak të arsimuara nuk po përfshinte një pjesë të madhe të popullsisë së cenueshme, e cila përfshinte shumë tunizianë të klasës së mesme dhe të arsimuar.

Vështirësia me të cilën përballemi ne si ekspertë të fushës dhe hulumtues është se ne bëjmë vlerësime për të identifikuar popullatat e cenueshme për programimin tonë. Nëse nuk e dimë se kush është popullata e cenueshme, si mund t'i përfshijmë ato në vlerësimin tonë? Në këtë mënyrë, ne përballemi me një lloj problemi si ai i “pulës dhe vezës”: ne dëshirojmë të përfshijmë të dhëna nga popullatat e cenueshme për të hartuar programin e duhur, por duhet të bëjmë vlerësimin për të identifikuar së pari popullsinë e cenueshme. Pavarësisht kësaj sfide, ajo që sugjeron shembulli i mëparshëm i Tunizisë është se ne mund të mendojmë në mënyrë më kritike se cilat janë subjektet e studimit tonë dhe se si të mbledhim lloje të ndryshme të të dhënave për të siguruar vlefshmërinë e brendshme.

Vlefshmëria e jashtme

Vlefshmëria e jashtme njihet gjithashtu si përgjithësueshmëria, që do të thotë se rezultatet nga kampioni janë të vërteta për popullatën më të gjerë. Megjithëse ky parim zakonisht i caktohet sferës së hulumtimit sasior, ai është i rëndësishëm edhe për atë cilësor. Për shembull, nëse zhvillojmë një diskutim me grupe fokusi me të rinj në një lagje të caktuar, duhet të jemi të kujdesshëm ose të vlerësojmë nëse gjetjet janë të vlefshme për të gjithë lagjen apo duhet t'i lidhim gjetjet vetëm me ata që morën pjesë në atë diskutim të caktuar me grupe fokusi.

Vlefshmëria e jashtme është një parim i vështirë për ekspertët e fushës të LEDH-së sepse EDH—dhe për rrjedhojë edhe hulumtimi mbi EDH-në—është hiperlokalizuar. Hulumtuesit mund të zbulojnë se faktori që nxit EDH-në në një fshat mund të mos jetë i njëjti që nxit EDH-në në një fshat tjetër. Ajo që nënkuptojmë është se përgjigja ndaj EDH-së duhet të përshtatet për të adresuar faktorët e veçantë nxitës në nënjësi të ndryshme lokale. Prandaj, shumë nga gjetjet e hulumtimit tonë nuk janë të përgjithësueshme. Ky nuk është një dështim kritik për hulumtimin tonë. Përkundrazi, ai tregon nevojën që hulumtuesit të jenë shumë të saktë kur të komunikojnë gjetjet dhe të shmangin bërjen e përgjithësimeve gjithëpërfshirëse.

Besueshmëria dhe saktësia

Saktësia i referohet afërsisë së përputhshmërisë midis një sërë matjesh. Hulumtuesit shpesh e përdorin atë si sinonim apo në vend të fjalës besueshmëri. Si besueshmëria, ashtu edhe saktësia nënkuptojnë se nëse matja do të kryhet përsëri—le të themi, nga një hulumtues tjetër—vlerat do të jenë të njëjta. Në diskutimin e mësipërm mbi qëndrimin, çështjet e besueshmërisë lindin kur matjet e qëndrimeve ndryshojnë me kalimin e kohës. Në hulumtimin cilësor besueshmëria dhe saktësia nënkuptojnë se nëse një intervistë kryhet përsëri ose kryhet nga një anketues tjetër, dëshmitë do të jenë të njëjta. Besueshmëria madje mund të shtrihet te llojet e informatorëve. D.m.th., nëse intervistohen të njëjtat lloje të informatorëve, a do të jenë të njëjta informacionet e tyre? Ndjekja, dokumentimi dhe ndarja e planit të mbledhjes, matjes dhe analizës së të dhënave është praktika më e mirë për arritjen e besueshmërisë.

Deduksioni

Çfarë përfundimesh logjike nxjerrim nga dëshmitë? Ky është parimi bazë i deduksionit. Në hulumtimet mbi EDH-në dhe LEDH-në, ekzistojnë tre lloje të zakonshme të të metave të deduksionit: mbështetja te produktet për të bërë deduksione për rezultatet; përdorimi i matjeve të qëndrimit për të bërë deduksione

për sjelljen; dhe përdorimi i dëshmive nga një nivel i analizës—siç është konteksti i vendit—për të bërë deduksione për një nivel tjetër analize—siç janë individët.

Në monitorimin dhe vlerësimin (MV) e programeve të LEDH-së, tendenca për t'u mbështetur te produktet (të tilla si numri i pjesëmarrësve në një trajnim) dhe jo te rezultatet e ndërhyrjeve të programit (të tilla si efekti që pati ndërhyrja në zvogëlimin e EDH-së) çon në mungesën e një baze të fortë dëshmish në lidhje me ndikimin e LEDH-së. Mbështetja te produktet, si në USAID, është pjesërisht një përgjigje ndaj donatorit, sepse programet e LEDH-së përfshijnë në mënyrë të pashmangshme disa tregues të ndihmës së huaj (d.m.th. treguesit F)²² që janë pothuajse tërësisht tregues të produkteve. Kjo është kryesisht për shkak se matja e produkteve është mënyra e vetme për të standardizuar matjen e ndihmës së huaj. Megjithatë, produktet nuk tregojnë ndikim për fenomenet shoqërore të ndërlikuara siç është EDH-ja dhe përgjigjet ndaj EDH-së. Prandaj, ne nuk mund të themi se kemi pasur ndikim në EDH për shkak se kemi trajnuar një numër të caktuar përfituesish. Në praktikën tonë, ne duhet të shkojmë përtej raportimit të numrit të përfituesve ose shërbimeve dhe më shumë drejt matjes së rezultateve.

Siç u diskutua më lart, mbështetja jonë në matjet e qëndrimit—në vend të atyre të sjelljes—në hulumtimin mbi LEDH-në do të thotë se dëshmitë mbi faktorët që ndryshojnë sjelljen janë të pakta. E thënë ndryshe, vetëm sepse ne mund të nxisim një ndryshim në qëndrim nuk do të thotë se kemi pasur ndonjë ndikim në sjellje. Ne nuk mund të përdorim dëshmi mbi qëndrimet për të bërë deduksione rreth sjelljes. Në fund të ditës, është sjellja ajo që duhet të ndryshojë për të luftuar në mënyrë efektive EDH-në. Siç kanë theksuar disa studiues, njerëzit mund të kenë qëndrime radikale pa u përfshirë kurrë në sjellje të dhunshme ose radikale dhe jo të gjithë terroristët radikalizojnë.²³

Së fundi, gabimi ekologjik, ose bërja e deduksioneve nga të dhënat ose dëshmitë në një njësi analize (zakonisht një matje konteksti) për të nxjerrë përfundime në lidhje me një njësi tjetër analize (zakonisht individë) është një pengesë e zakonshme në praktikën tonë. Në fillim të viteve 2000, një hipotezë e përhapur ishte se varfëria nxit terrorizmin. Kjo hipotezë lindi nga studimet në nivel vendi që shqyrtonin lidhjen midis incidenteve kombëtare të dhunës dhe një sërë matjesh kombëtare të varfërisë (të tilla si PBB dhe pabarazia). Shumë studime në nivel kombëtar të kryera që prej asaj kohe kanë treguar se nuk është ky rasti²⁴. Sidoqoftë, deduksionet që varfëria nxit terrorizmin u shtrinë në nivelin individual: njerëzit e varfër kanë më shumë gjasa të jenë terroristë.

Megjithatë, studimet në nivel individual kanë treguar se shumë njerëz që kryejnë akte terroriste vijnë nga klasa e mesme ose familje të ngritura dhe se ata kryejnë akte terroriste për një sërë arsyesh të ndryshme.

22 Shih Standard Foreign Assistance Indicators, U.S. Department of State (Treguesit Standardë të Ndhmës së Huaj, Departamenti Amerikan i Shtetit), arkivuar, aksesuar në 1 shtator 2019, <https://2009-2017.state.gov/f/indicators/>

23 Randy Borum, "Radicalization into Violent Extremism II: A Review of Conceptual Models and Empirical Research." (Radikalizimi në ekstremizmin e dhunshëm II: Një rishikim i modeleve konceptuale dhe hulumtimeve empirike.) *Journal of Strategic Security (Revista e Sigurisë Strategjike)*, 4(4) 2011: 37-62; Clark McCauley dhe Sophia Moskalenko, "Mechanisms of Political Radicalization: Pathways toward Terrorism." (Mekanizmat e radikalizimit politik: Rrugët drejt terrorizmit). *Terrorism and Political Violence (Terrorizmi dhe dhuna politike)* 20, 2008: 415–33; Fernando Reinares, *Radicalisation Processes Leading to Acts of Terrorism: A Concise Report Prepared by the European Commission's Expert Group on Violent Radicalisation* (Proceset e radikalizimit që çojnë në akte terrorizmi: një raport konciz i përgatitur nga Grupi i Ekspertëve i Komisionit Evropian për Radikalizimin e Dhunshëm), European Commission (Komisioni Evropian), 2008.

24 Shih, për shembull, James A Piazza, "Rooted in Poverty?: Terrorism, Poor Economic Development, and Social Cleavages" (Të rrënjosur në varfëri?: Terrorizmi, zhvillimi i dobët ekonomik dhe ndarjet shoqërore), *Terrorism and Political Violence (Terrorizmi dhe dhuna politike)*, 18(1) 2007: 159-177.

“Një nga njohuritë më domethënëse të marra nga hulumtimet akademike gjatë viteve të fundit është se individët e përfshirë në veprimtari terroriste shfaqin një larmi kontekstesh sociale, i nënshtrohen proceseve mjaft të ndryshme të radikalizimit të dhunshëm dhe ndikohen nga kombinime të ndryshme të motiveve.”²⁵ Për ta përmbledhur, ne nuk mund të nxjerrim përfundime për një nivel analize bazuar në dëshmi nga një nivel tjetër analize.

PROBLEMATIKAT PËR POLITIKAT DHE PRAKTIKËN

Për të kuptuar problematikat e kryerjes së hulumtimeve të dobëta për politikën dhe praktikën, është e këshillueshme të merren parasysh mësimet e nxjerra nga fushat e përcaktuara. Le të marrim për shembull praktikën mjekësore. Për mijëra vjet, njerëz të admiruar dhe karizmatikë praktikuan mjekësinë duke dhënë receta me trajtime të bazuara në anekdota, paragjykime dhe ndoshta shumë kurthe psikologjike, të tilla si paragjykimi i konfirmimit dhe disonanca konjitive.²⁶ Zhvillimet e hershme në shëndetin publik ndodhën përmes politikave që synonin luftën kundër problemeve urbane, të tilla si kanalizimet, strehimi dhe sëmundjet infektive—por jo nga mjekët. Mjekësia kaloi në praktikën e bazuar në dëshmi vetëm 25-30 vitet e fundit, me lindjen e teknologjisë më të mirë hulumtuese—veçanërisht të eksperimenteve të randomizuara. Shumë mjekë të vjetër e qortuan këtë kalim; vetëm kohët e fundit, pasi ata mjekë u larguan, praktika e bazuar në dëshmi ka fituar terrenin e vet.²⁷

Ndërsa dëshmitë kanë çuar përpara fushën mjekësore, ato gjithashtu hodhën dritë mbi **atë që nuk duhej bërë**. Sipas profesorit të politikave të kujdesit shëndetësor të “Harvardit”, Anupam Jena, shkenca sjell ndryshime mjekësore në rreth 15% të kohës.²⁸ Problemi është se trupi i njeriut është një organizëm kompleks, gjë që e bën të vështirë diagnostikimin dhe trajtimin e problemeve shëndetësore. Në mënyrë të ngjashme, LEDH merret me fenomene sociale komplekse brenda sistemeve të shumëfishta komplekse, gjë që e bën më të vështirë për ta hetuar. Ne duhet të ndjekim praktikën standarde të hulumtimit të bazuar në dëshmi për të gjeneruar bazën e njohurive të nevojshme për të kuptuar më mirë se si të ndërhyjmë në mënyrë efektive në përgjigje të EDH-së dhe për të ditur se çfarë nuk duhet të bëjmë.

Për LEDH-në, politikëbërësit me përvojë dhe specialistët e lartë ushtarakë nuk i kanë përputhur aftësitë me këto sfida. Ata u fokusuan tërësisht në politikën e jashtme gjatë epokës së Luftës së Ftohtë, kur kërcënimi i madh ishte një shtet-komb tjetër—një sfidë me të cilën shtetet janë praktikuar për shekuj me radhë. Të trajnuar për të adresuar kërcënimet në nivel shtetëror, politikëbërësit e lartë kanë marrë

25 Reinales, *Radicalisation Processes Leading to Acts of Terrorism (Proceset e radikalizimit që çojnë në akte terrorizmi)*, 11; Shih McCauley and Moskalenko, “Mechanisms of Political Radicalization” (Mekanizmat e radikalizimit politik); Borum, “Radicalization into Violent Extremism II” (Radikalizimi në ekstremizmin e dhunshëm II); Schmid, *The Routledge Handbook of Terrorism Research*.

26 Paragjykimi i konfirmimit është prirja për të interpretuar dëshmitë e reja në një mënyrë që përputhet me besimet e mëparshme. Për shembull, nëse besoni se fëmija juaj është i çrregullt, ky besim do të konfirmohet nga të gjitha rastet kur ai i lë rrobat në dysheme dhe lodrat e shpërndara nëpër shtëpi. Disonanca konjitive i referohet sikletit që ndiejnë njerëzit kur bindjet dhe sjellja e tyre janë në kundërshtim me njëra-tjetrën. Për shembull, duhanpirësit mund të kenë disonancë konjitive rreth pirjes së duhanit. Ata mund të besojnë se pirja e duhanit është e dëmshme për shëndetin dhe mund të dëshirojnë ta lënë, por vazhdojnë të pinë duhan.

27 Për një diskutim më gjithëpërfshirës rreth këtij evoluimi, shihni Podcast-in Freakonomics 3-pjesësh “Bad Medicine” (Mjekësia e keqe) 2016, <http://freakonomics.com/podcast/bad-medicine-part-1-story-98-6/>.

28 Shihni Podcast-in Freakonomics “Bad Medicine” (Mjekësia e keqe) 2016, <http://freakonomics.com/podcast/bad-medicine-part-3-death-diagnosis/>.

vendime të vështira në luftën kundër terrorizmit, një problem kompleks i aktorëve joshtetërorë. Siç dëshmon mandati i fundit i Kongresit i dhënë “United States Institute of Peace, USIP” (Instituti i Paqes i Shteteve të Bashkuara (USIP)) për të krijuar një task forcë për EDH-në në shtete të brishta, përgjigjja ndaj terrorizmit nuk e ka ndaluar EDH-në të përhapet në të gjithë globin.²⁹ Gjetjet dhe rekomandimet e task forcës së USIP tregojnë nevojën për të bërë më shumë përpjekje për parandalimin dhe më pak për luftimin e këtij fenomeni.³⁰ Koha do të tregojë nëse vendimmarrësit e rangut të lartë do të drejtojnë këtë thirrje për të ndryshuar.

Ndërkohë, në lidhje me bordin, qeveria duket se po i përgjigjet gjithnjë e më mirë dëshmive sesa përvojës apo mendimit të ekspertit. Kongresi Amerikan ka ngritur zërin për të treguar ndikimin e bazuar në dëshmi të programimit të LEDH-së. Çka është më e rëndësishme, ekziston një nevojë e vërtetë njerëzore për të krijuar përgjigje më të mira për të ndihmuar në vendosjen e paqes për njerëzit që jetojnë nën rrethimin e OEDH-ve. Kthimi në bazat e hulumtimit për të siguruar dëshmitë më të plota dhe rigorozë të mundshme dhe ndërtimi sistematik i një korpusi njohurish nga gjetjet e kësaj baze të dëshmive, është mënyra se si hulumtuesit dhe analistët mund të bëjnë pjesën e tyre të punës për të përmirësuar reagimin e përgjithshëm ndaj EDH-së dhe për të kontribuar në një botë më paqësore.

29 Task Force on Extremism in Fragile States, “Preventing Extremism in Fragile States: A new approach,” (Task forca për ekstremizmin në shtetet e brishta, “Parandalimi i ekstremizmit në shtetet e brishta: Një qasje e re”) *U.S. Institute of Peace (Instituti Amerikan i Paqes)*, 26 shkurt, 2019. <https://www.usip.org/publications/2019/02/preventing-extremism-fragile-states-new-approach>

30 Task Force on Extremism in Fragile States, “Preventing Extremism in Fragile States: A new approach” (Task forca për ekstremizmin në shtetet e brishta, “Parandalimi i ekstremizmit në shtetet e brishta: Një qasje e re”)

BURIMET

- Agence Tunis Afrique Presse. "A large proportion of terrorists in Tunisia are university graduates (study)." (Një pjesë e madhe e terroristëve në Tunizi janë të diplomuar në universitet (studim) 26 tetor 2016. <https://www.tap.info.tn/en/Portal-Society/8362201-a-large-proportion-of-terrorists-in>
- Ahmadi, Belquis and Eliza Urwin "Measuring Peace and Violent Extremism," (Matja e Paqes dhe Ekstremizmit të Dhunshëm) *U.S. Institute of Peace (Instituti Amerikan i Paqes)*, 16 mars 2018.
- Berger, J.M. "Researching Violent Extremism: The State of Play" (Hulumtimi i ekstremizmit të dhunshëm: Gjendja aktuale) *RESOLVE*, 23 qershor 2019. <https://resolvenet.org/research/researching-violent-extremism-state-play>
- Borum, Randy. 2011. "Radicalization into Violent Extremism II: A Review of Conceptual Models and Empirical Research." (Radikalizimi në ekstremizmin e dhunshëm II: Një rishikim i modeleve konceptuale dhe hulumtimeve empirike.) *Journal of Strategic Security (Revista e Sigurisë Strategjike)*, 4(4) 2011: 37-62.
- Ethical Principles for Medical Research. "The Nuremberg Code." (Parimet Etike për Kërkimin Mjekësor. Kodi i Nurembergut.) Aksuar në 1 shtator 2019, <https://sites.jamanetwork.com/research-ethics/index.html>
- Feldman, Stanley dhe John Zaller. "The Political Culture of Ambivalence: Ideological Responses to the Welfare State." (Kultura Politike e Ambivalencës: Përgjigje ideologjike ndaj Shtetit të Mirëqenies) *American Journal of Political Science (Revista Amerikane e Shkencave Politike)* 36(1) 1992: 268-307.
- Freakonomics Podcast. "Bad Medicine." (Mjekësia e keqe) 2016. <http://freakonomics.com/podcast/bad-medicine-part-1-story-98-6/>.
- Karlan, Dean and Jacob Appel. *Failing in the Field: What we can learn when field research goes wrong.* (Dështimi në terren: Çfarë mund të mësojmë kur hulumtimi në terren shkon keq). Princeton, NJ: Princeton University Press, 2016.
- King, Gary, Robert O. Keohane, and Sidney Verba. *Designing Social Inquiry: Scientific inference in qualitative research.* (Hartimi i Hetimit Social: Konkluzion shkencor në hulumtimin cilësor). Princeton, NJ: Princeton University Press, 1994.
- Maoz, Zeev. "Case Study Methodology in International Studies: From storytelling to hypothesis testing." (Metodologjia e rasteve studimore në studimet ndërkombëtare: Nga tregimi te testimi i hipotezës.) In *Evaluating Methodology in International Studies: Millennial reflections on International Studies, (Vlerësimi i metodologjisë në studimet ndërkombëtare: Reflektime mijëvjeçare mbi studimet ndërkombëtare)* redaktuar nga Frank P. Harvey dhe Michael Brecher 455-75. Ann Arbor: University of Michigan Press, 2002.
- McCauley, Clark, and Sophia Moskalenko. "Mechanisms of Political Radicalization: Pathways toward Terrorism." (Mekanizmat e radikalizimit politik: Rrugët drejt terrorizmit.) *Terrorism and Political Violence (Terrorizmi dhe dhuna politike)* 20, 2008: 415-33.
- McLeod, Saul. "The Milgram Shock Experiment." (Eksperimenti i Milgramit). *Simply Psychology*. 2017. <https://www.simplypsychology.org/milgram.html>
- McLeod, Saul. "The Stanford Prison Experiment." (Eksperimenti në burg i Stenfordit). *Simply Psychology*. 2018. <https://www.simplypsychology.org/zimbardo.html>
- Mishler, William, and Richard Rose. "What Are the Origins of Political Trust?" (Cila është Origjina e Besimit Politik?) *Comparative Political Studies (Studimet politike krahasuese)* 34 (1) 2001:30-62.
- Piazza, James A. "Rooted in Poverty?: Terrorism, Poor Economic Development, and Social Cleavages," (Të rrënjosur në varfëri?: Terrorizmi, zhvillimi i dobët ekonomik dhe ndarjet shoqërore), *Terrorism and Political Violence (Terrorizmi dhe dhuna politike)*, 18(1) 2007: 159-177.
- Ragin, Charles C. *Fuzzy-Set Social Science*. Chicago, IL: Chicago University Press, 2000.
- Reinares, Fernando. *Radicalisation Processes Leading to Acts of Terrorism: A Concise Report Prepared by the European Commission's Expert Group on Violent Radicalisation.* (Proceset e radikalizimit që çojnë në akte terrorizmi: Një raport konciz i përgatitur nga Grupi i Ekspertëve i Komisionit Evropian për Radikalizimin e Dhunshëm). European Commission, 2008.
- Romaniuk, Peter. "Does CVE Work? Lessons Learned from the Global Effort to Counter Violent Extremism" A funksionon LEDH? Mësimet e nxjerra nga përpjekjet globale për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm), *Global Center on Cooperative Security (Qendra Globale për Sigurinë Bashkëpunuese)*, shtator 2015.
- Schedler, Andreas and Rodolfo Sarsfield. "Democrats with Adjectives: Linking Direct and Indirect Measures of Democratic Support." („Demokratët me mbiemra: Lidhja e masave direkte dhe indirekte të mbështetjes demokratike.") *European Journal of Political Research (Revista Evropiane e Hulumtimit Politik)* 46(5) 2007: 637-659.
- Schmid, Alex P., ed. *The Routledge Handbook of Terrorism Research*. London, UK: Routledge, 2011.
- Task Force on Extremism in Fragile States. (Task forca për ekstremizmin në shtetet e brishta). "Preventing Extremism in Fragile States: A new approach." (Parandalimi i ekstremizmit në shtetet e brishta: Një qasje e re.) 26 shkurt 2019. <https://www.usip.org/publications/2019/02/preventing-extremism-fragile-states-new-approach>
- USAID. Learning Lab. Aksuar në 1 shtator 2019. <https://usaidlearninglab.org/>
- U.S. Department of Commerce. (Departamenti Amerikan i Tregtisë). National Institute of Standards and Technology. (Instituti Kombëtar i Standardeve dhe Teknologjisë). Aksuar në 1 shtator 2019, www.nist.gov
- U.S. Department of Health and Human Services. (Departamenti Amerikan i Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore). "Belmont Report." (Raporti i Belmontit) Aksuar në 1 shtator 2019. <https://www.hhs.gov/ohrp/regulations-and-policy/belmont-report/index.html>
- U.S. Department of Health and Human Services. (Departamenti Amerikan i Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore). "IRB Registration." (Regjistrimi IRB) Aksuar në 1 shtator 2019. <https://www.hhs.gov/ohrp/register-irbs-and-obtain-fwais/irb-registration/index.html>
- U.S. Department of State. (Departamenti Amerikan i Shtetit). Standard Foreign Assistance Indicators. (Treguesit Standardë të Ndhmës së Huaj). Arkivuar, aksuar në 1 shtator 2019. <https://2009-2017.state.gov/f/indicators/>